

TAKIMI I DYTË 2024 - KOMITETI SEKTORIAL I MIKPRITJES DHE TURIZMIT

Mbledhja e dytë e Komitetit Sektorial të Mikpritjes dhe Turizmit u mbajt më datë **13.07.2024**.

Mbledhja u hap nga Sekretariati Teknik, që informoi se, takimi do të përqëndrohej në diskutimin e standardeve të profesioneve dhe standardeve të kualifikimeve profesionale, që ishin përgatitur gjatë vitit 2024 për fushën e “Hoteleri - Turizmit”. Sekretariati Teknik shpjegoi për anëtarët procesin e hartimit dhe validimit të dokumenteve.

Sekretariati Teknik prezantoi funksionet dhe detyrat për standardin e profesionit: **“Menaxher i mesëm në struktura akomoduese”**. Pas diskutimeve për standardin, anëtarët e validuan dokumentin pa ndryshime dhe aprovuan se funksionet dhe detyrat e përcaktuara, ishin ato që kërkonin bizneset në treg.

Më pas, Sekretariati Teknik prezantoi standardin e profesionit: **“Kamarier - Banakier”**, i cili u validua pa komente. Në vijim u prezantua standardi i profesionit: **“Operator turistik”**. Anëtarët e validuan përmbajtjen e standardit dhe sugjeruan që emërtimi i standardit të ishte: **“Menaxher i mesëm në operator turistik”**. Rekomandimi u pasqyrua në dokument dhe u validua pa ndryshime të tjera.

Sekretariati Teknik kaloi në prezantimin e standardeve të profesioneve: **“Receptionist në hotel”**, **“Pastiçier”**, **“Nënpunës i guidave turistike”** dhe **“Punonjës i kualifikuar në hotel dhe restorant”**, të cilët anëtarët i validuan pa ndryshime.

Pas validimit të standardeve të profesioneve, u kalua në validimin e standardeve të kualifikimeve profesionale. Sekretariati Teknik prezantoi njësitë e të nxënit dhe peshat specifike në % për çdo njësi të nxëni, për çdo standard kualifikimi profesional.

Pas prezantimit të standardeve të kualifikimeve profesionale: **“Bar - Restorant”**, niveli III në KSHK, **“Hoteleri”**, niveli III në KSHK (EHL), **“Kuzhinë”**, niveli III në KSHK (EHL), **“Shërbime ushqimi dhe pije”**, niveli III në KSHK (EHL), **“Menaxhim i strukturave akomoduese”**, niveli V në KSHK, **“Shërbime udhëtimi dhe turizmi”**, niveli IV në KSHK, **“Guidë turistike”**, niveli IV në KSHK, **“Reception”**, niveli III në KSHK, **“Pastiçeri”**, niveli III në KSHK dhe **“Shërbime në hotel dhe restorant”**, niveli III në KSHK, anëtarët vendosën validimin e dokumenteve pa ndryshime.

Vendime të marra nga mbledhja:

- U validuan pa ndryshime standardet e profesioneve: ***“Menaxher i mesëm në struktura akomoduese”***, ***“Kamarier - banakier”***, ***“Receptionist në hotel”***, ***“Punonjës i kualifikuar në hotel dhe restorant”***, ***“Nënpunës i guidave turistike”*** dhe ***“Pastiçier”***.
- U propozua ndryshimi i titullit për standardin e profesionit: ***“Operator turistik”*** në ***“Menaxher i mesëm në operator turistik”*** dhe dokumenti u validua pa ndryshime.
- U validuan pa ndryshime standardet e kualifikimeve profesionale: ***“Menaxhim i strukturave akomoduese”***, niveli V në KSHK, ***“Bar - Restorant”***, niveli III në KSHK, ***“Shërbime udhëtimi dhe turizmi”***, niveli IV në KSHK, ***“Guidë turistike”***, niveli IV në KSHK, ***“Reception”***, niveli III në KSHK, ***“Pastiçeri”***, niveli III në KSHK, ***“Shërbime në hotel dhe restorant”***, niveli III në KSHK, ***“Hoteleri”***, niveli III në KSHK, ***“Kuzhinë”***, niveli III në KSHK dhe ***“Shërbime ushqimi dhe pije”***, niveli III në KSHK.